



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1216/2 Prot.

Pogradec, më 23.03.2021

VENDIM

NR. 29, DATË 19.03.2021

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË POGRADEC, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z.EDMOND KUQO, PËR SHKAK TË DËMTIMIT TË BANESËS, NGA RËNIA E ZJARRIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasit Edmond Kuqo. dëmtimin e banesës së tij nga rënia e zjarrit në datën 17.02.2021
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Edmond Kuqo, ndihmën emergjente në vlerën prej **132849 lek** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2021.
4. Ndihma financiare që do të akordohet, do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Edmond Kuqo banesa e të cilit është demtuar nga rënia e zjarrit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe objekteve në Bashkëpronësi, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas lajmërimit të subjektit nga drejtoria përkatëse.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Jona BOJKO



KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

